



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:161364
Datë: 14.06.2024
Numri i dokumentit: 05825831

K.DH.SH.II.nr.166/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës, kundër debitorit "Ventius International" L.L.C , me nr. Biznesit 810748923 me seli ne Gjakovë rr." Nënë Tereza", me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit te ushtruar përmes Shoqërisë se Avokateve "SCLR Partners" sipas autorizimit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë-Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1135/23 dt.01.12.2023, me datë 14.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit "Ventius International" L.L.C , me nr. Biznesit 810748923 me seli ne Gjakovë rr." Nënë Tereza", ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë -Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1135/23 dt.01.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1135/23 dt.01.12.2023, në pikën I. të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit "Ventius International" L.L.C , me nr. Biznesit 810748923 me seli ne Gjakovë rr." Nënë Tereza" dhe e ka anuluar pjesërisht Urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.339/23 dt.16.06.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi me seli ne Gjakovë, sa i përket detyrimit për pagesën e kamatës ligjore dhe për këtë pjesë procedura përmbarimore përfundohet. Në pikën II të dispozitivit të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka refuzuar pjesërisht si te pabazuar prapësimin e debitorit "Ventius International" L.L.C , me nr. Biznesit 810748923 me seli ne Gjakovë rr." Nënë Tereza" duke e lënë në fuqi pjesën tjetër te Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.339/23 dt.16.06.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi, për detyrimin kryesor në shumën prej 1,000.00 € (një mijë euro).

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përbarimore dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë në tërësi si të bazuar prapësimin debitorit të parashtruar kundër pikës II të dispozitivit të aktvendimit të atakuar ashtu që për këtë pikë çështja të kthehet në shkallë të parë në rishqyrtim.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, i shqyrtuan shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës, ka parashtruar propozim për përbarim, me datën 16.06.2023, kundër debitorit "Ventius International, sipas dokumentit përbarues – Vendimit Nr. 830/2022 dt.14.09.2022 të lëshuar nga Inspektorati i Punës. Përbaruesi Privat Gjakë Radi, duke vepruar sipas propozimit për përbarim, përmes urdhrin përbarimor P.nr.339/23 dt.16.06.2023, detyron debitorin që sipas vendimit të sipër cekur t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,000.00€ (një mijë euro) me kamatë ligjore duke filluar prej datës 26.04.2023 e deri në pagesën përfundimtare, me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe llogarive tjera ndihmëse deri në bartjen e shumës së cekur.

Kundër këtij urdhri përbarimor debitori me datën 29.06.2023, ka ushtruar prapësim me pretendimin se është vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendja faktike, ndër tjera shton se debitori ka ngritur kontest administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe ta shfuqizoj urdhrin përbarimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë pas vlerësimit të prapësimin dhe shkresave tjera, ka nxjerr aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1135/23 dt.01.12.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka anuluar pjesërisht Urdhrin për lejimin e përbarimit, për pjesën e kamatës ligjore si dhe ka vendosur që të mbetet në fuqi pjesa tjetër e urdhrin për lejimin e përbarimit për pjesën e detyrimit kryesor. Me rastin e vendosjes, gjykata e shkallës së parë ka vepruar sipas pikës I të dispozitivit të aktvendimit sepse obligimi i debitorit për pagesën e kamatës ligjore nga data 26.04.2023 e deri në pagesën definitive nuk është në përputhje me dokumentin përbarimor pasi vendimi nr.830/22 dt.14.09.2022 ka obliguar debitorin që të paguaj shumën e detyrimit prej 1,000.00 euro në emër të masës ndëshkimore por jo edhe kamatën ligjore, ndërsa sipas pikës II të dispozitivit të aktvendimit gjykata ka gjetur se vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi nr.830/22 dt.14.09.2022 i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 27 par.1 të LPP dhe së ky vendim i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara edhe me nenin 36 par.1 të LPP. Gjykata ka vlerësuar se pretendimet e debitorit se

ndaj vendimit përfundimtar të kreditorit është iniciuar konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse padia e paraqitur për zhvillim të konfliktit administrativ nuk paraqet pengesë për ekzekutim të vendimit mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartimor, konform nenit 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata mori parasysh edhe pretendimin e debitorit se vendimi mbi të cilin është lejuar përmbartimi është nxjerr pa u vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike por gjeti se i njëjti pretendim nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit në këtë procedurë sepse bazuar në parimin e rigorozitetit formal gjykata nuk ka tagër të lëshohet në ligjshmërinë e vendimit si titull ekzekutiv, andaj edhe mbi këto arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke shfuqizuar pjesërisht urdhrin sa i përket pjesës së kamatës së kërkuar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka vendosur sipas prapësimit të debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të aktit administrativ i paraparë me nenin 22 par.1 pika 1.2 e LPP si dokument përmbartues.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka konstatuar se dokument përmbartues në rastin konkret paraqet akti administrativ i organit të administratës i nxjerr në pajtim me rregullat në atë procedurë siç parashihet me nenin 24 par. 3 të LPP-së. Së këndejmi edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbartimore organi përmbartues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbartimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e aktit administrativ të nxjerrë në procedurën e brendshme administrative. Andaj, organi përmbartues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbartues, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit rigoroz formal të titullit ekzekutiv, pra gjykata nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e procedurës së brendshme administrative të zhvilluar para organit të administratës, përderisa vendimi i tillë përbën akt administrativ i cili cilësohet si dokument përmbartimor, ashtu që objekt i kësaj procedure është vetëm rregullsia formale e dokumentit përmbartimor, i cili edhe për gjykatën e shkallës së dytë paraqet dokument të përshtatshëm për përmbartim, konform dispozitave të nenit 24 par.3 dhe 27 të LPP-së.

Bazuar në këto arsye, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës ka marr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe sipas kësaj gjykate aktvendimi i atakuar nuk është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

Sipas kësaj gjykate, aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësoi se akti administrativ i nxjerr nga kreditori në procedurë të brendshme, i cili në aspektin formal përmban të gjitha kushtet e parapara ligjore nga Neni 27 par.1 i LPP-së, me të cilin përcaktohet se “*Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit*”. Po ashtu edhe kjo gjykatë vlerëson faktin se padia e paraqitur për zhvillim të konfliktit administrativ nuk paraqet pengesë për ekzekutim të vendimit mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartimor.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.166/24, me datë 14.06.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi